



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

---

Nr. 512/4 Prot.

Tiranë, më 26 /09/2017

### V E N D I M

**Nr. 125, Datë 26.09.2017**

#### **EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DREJTORINË PËRGJITHSHME TË ALUIZNI-t, TIRANË “MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROÇEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, Drejtorit Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25,26 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Tiranë, për periudhën nga data 01.01.2015 deri me datë 30.06.2017.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në Drejtorinë e Përgjithshme e ALUIZNI-t, është konstatuar se; në vitin 2016 në totalin e fondit të pagave prej 380,964 mijë lekë, fondi i pagave i

shpenzuar për punonjësit me kontratë zë një peshë të konsiderueshme në vlerë prej 144,345 mijë lekë ose në masën 38 % dhe në totalin e fondit për sigurimet shoqërore prej 64,035 mijë lekë, fondi i shpenzuar për punonjësit me kontratë zë një peshë të konsiderueshme në vlerë prej 25,255 mijë lekë. Raportimi i këtyre shpenzimeve në vlerë 169,600 mijë lekë (144,345 mijë lekë + 25,255 mijë lekë) në Grupin 602 “Shpenzime operative” sjell një deformim të fondit të pagave deklaruar nga ky Institucion. Ky zë përbën rritje rreth 50 % të fondit total të raportuar .

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, të marrë masat që për sa kohë konstatohet nevoja për staf të eliminoje risqet e larta operationale që ka stafi i marrë me kontratë duke studiuar me kujdes nevojat për staf e fond dhe të kërkojë ndryshimin e strukturës me Vendimin e Këshillit të Ministrave të miratuar nga Kryeministri.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nuk ka shkresë nga ana e NA të njësisë, për delegimin e rolit të koordinatorit të riskut tek një nëpunës tjetër i nivelit menaxherial. Nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut, pavarësisht se sipas përcaktimeve në ligj kjo është detyrë e vetë NA, në kundërshtim me ligjin nr. 10269, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**2.1 Rekomandim:** Nga Nëpunësi Autorizues të përcaktohen përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e stafit të lartë, të mesëm dhe të ulët menaxherial, nuk janë kryer trajnime të mjaftueshme për njohjen e tyre me kërkesat e ligjit, njohjen me procesin e evidentimit dhe menaxhimit dhe monitorimit të riskut, në kundërshtim me ligjin nr. 10269, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

**3.1 Rekomandim:** Nga Drejtoria Qendrore e ALUIZNI-t, të merren masa që të kryhen trajnime të stafit, mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së.

*Vazhdimisht.*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, janë plotësuar formularët e raporteve të monitorimit për çdo tremujor dhe janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në MZHU. Këto raporte nuk janë të shoqëruara me analizën e treguesve financiare si dhe të objektivave dhe produkteve përkatëse .

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, të marrë masat që formularët e raporteve të monitorimit të shoqërohen me analizën e treguesve financiarë, me qëllim përmirësimin e planifikimit të kërkesave të programit në periudhat e ardhshme.

*Në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 768/15, datë 24.12.2014, ka dërguar në Drejtorinë Përgjithshme ALUIZNI-t Tiranë, Raportin Përfundimtar të Auditimit, së bashku me rekomandimet përkatëse. Me shkresën nr. 6366/5, datë 16.01.2015 lënda: “Mbi masat e rekomanduara në kuadër të auditimit” Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t” ka kthyer përgjigje duke cilësuar masën e zbatimit të rekomandimeve. Nga auditimi zbatimit të rekomandimeve u konstatua se për 4 rekomandime nuk ka përgjigje zyrtare dhe masa të dokumentuara për zbatimin e tyre

*Rekomandim pjesërisht i zbatuar, pasi në momentin e auditimit janë arkëtuar 62,860 lekë*

**5.1. Rekomandim:** Për rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm dhe të pa trajtuara nga subjekti i audituar, Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t të marrë masa me qëllim që:

- Dorëzimi dhe marrja e detyrës të bëhet e dokumentuar, konform ligjit;
- Të marrë të dhënat nga të gjitha Drejtoritë Rajonale, të ndiqen dhe të përpunohen të dhënat për objektet e shkualifikuar, që janë ndërtuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Të kthehet përgjigje për të gjitha kërkesat dhe ankesat e personave fizike dhe juridike, duke ndjekur me përparësi verifikimin e tyre sipas rrjedhës shteruese;
- Nxjerrjen e akteve administrative nga titullarit të njësisë publike (nëpunësit autorizues), për kërkimin për shpërbllimin e dëmit të rezultuar nga auditimi, për pagesa të pa drejta në udhëtime e dieta brenda vendit;
- Marrjen e masave për kryerjen e pagesës si ndihmë e menjëhershme ndaj nëpunësit *P.B* i cili ka dalë në pension pleqërie, duke zbatuar dispozitat ligjore në fuqi brenda fondeve te parashikuara.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në Drejtorinë e Përgjithshme u konstatua se nga shuma totale e vetëdeklarimeve gjithsej 463196 objekte, rezultojnë 17000 objekte te kualifikuara nga Drejtoritë Rajonale por të pa pajisur me leje legalizimit duke u ndërprerë procedurat e legalizimit në mënyrë të pa dokumentuar dhe në kundërshtim me ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 10, pika (C) si dhe neni 27, 28 si dhe VKM 589, datë 10.09.2014, pika 10 si dhe VKM 280, datë 01.04.2015 kreu i IV, pika (8), si dhe VKM nr.1095, datë 28.12.2015 pika 2 .

**6.1. Rekomandim:** Drejtoria e Përgjithshme t’i kërkojë Drejtorive Rajonale evidentimin e rasteve të objekteve të vetëdeklaruarra për të cilat kanë përfunduar procedurat e kualifikimit dhe nuk janë pajisur me leje legalizimi si dhe të ndjekë me program konkret përfundimin e procedurave të legalizimit për këto objekte.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në hartimin e planeve vjetorë të auditimit nuk janë parashikuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 (ndryshuar me ligjin nr. 10318 datë 16.09.2010) “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 7, neni 11 “Përgjegjësitë e drejtuesve të subjekteve publike për auditimin e brendshëm” si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave.

Për vitin 2015 janë planifikuar 16 auditime të plota janë realizuar 6 auditime të plota ose vetëm 37 % planit. Për vitin 2016 janë planifikuar 16 auditime të plota janë realizuar 5 auditime të plota ose vetëm 37 % planit. Në raportet e veprimtarisë vjetore nuk arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan veprime në kundërshtim me ligjin 114/2015 Neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm” si dhe me Manualin e Auditimit. Programet e auditimit jo në të gjitha

rastet janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit, Manualit të auditimit dhe standardeve të auditimit të brendshëm .

**7.1. Rekomandim:** Nga Sektori i Auditimit të brendshëm të merren masa me qëllim që:

-Në hartimin e planeve vjetore të auditimit, të parashikohet auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme:

- Të arsyetohet shkresërisht në raportet e veprimtarisë vjetore mos realizimi i planit të auditimit, si dhe shmangiet nga ky plan,

-programet e auditimit të hartohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe manualit të auditimit të brendshëm.

*Në vijimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:** Drejtorja e Përgjithshme e ALUIZNI-t, për paditë civile të ngritura nga punonjësit e larguar nga puna, ka ndjekur procedurat në të gjitha shkallët e gjyqësorit, nga ku rezulton se 4 punonjës kanë përfituar dëmshpërblim në shumën 3,004,470 lekë, “Për largim të padrejtë nga puna”, e cila përbën efekt ekonomik negativ për buxhetin e shtetit. Sipas strukturës së paraqitur vendet e tyre në strukturë nuk janë suprimuar, dhe në këto kushte janë kryer pagesat për 2 punonjës në të njëjtin pozicion pune.

**8.1. Rekomandim:** Drejtorja e Përgjithshme e Përgjithshme e ALUIZNI-t, të marr masa që për largimet dhe rekrutimet e punonjësve, të zbatojë procedurat ligjore duke respektuar afatet kohore të njoftimeve për largimet nga puna, me qëllim eliminimin e efektit ekonomik negativ shkaktuar buxhetit të shtetit si pasojë e dëmshpërblimit të përfituar nga punonjësit me vendimet gjyqësore për largim të padrejtë nga puna.

*Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtorja Përgjithshme e ALUIZNI-t në organizimin procedurave të prokurimit nuk është vepruar në përputhje me kërkesat ligjore pasi:

-Nga auditimi i procedurave të prokurimit të vitit 2015 në 9 raste me vlerë totale 29,614 mijë lekë nga të cilat: 3 procedura me negociim pa shpallje, 2 procedura kërkesë për propozim, dhe 4 proceduar të përqendruara nga Ministria e Brendshme, në vitin 2016 janë 3 proceduara prokurime me negociim pa shpallje në vlerë totale 2,163 mijë lekë dhe në vitin 2017 për 3 procedura prokurime me negociim pa shpallje në vlerë 2,456 mijë lekë, konstatohet se në dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar vendosja e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”

-Për procedurat e prokurimit “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” me objekt “Shërbimi i ruajtjes fizike të ambienteve”, konstatohet se janë ftuar dhe shpallur fitues të njëjtët operatorë ekonomikë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 1, 2 dhe 33, pika 6.

-Dosjet e tenderave nuk janë inventarizuar dhe arkivuar, megjithëse janë përfunduar në vitin 2015 dhe 2016 në përfundim të çdo procedure prokurimi dhe për çdo dosje njësia e

prokurimit nuk ka kryer inventarizimin e brendshëm të saj, në përputhje me nenin 30, Modeli nr. 8 “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”, miratuar nga DP e Arkivave, në zbatim të neneve 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”.

-Në procesverbalet e punës së komisioneve të negocimit, për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në asnjë rast analizohen ofertat dhe negocimi i tyre nga komisioni thjesht është kryer renditja dhe klasifikimi paraqitur vetëm dokumentacioni dhe vlera e ofertës dhe në asnjë rresht nuk ka gjurmë për negocimin e ofertës së paraqitur.

-Në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga Autoriteti Kontraktor, në tenderin me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike”, me fond limit 2,305 mijë lekë, për kriteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike, janë kërkuar kërkesa të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara, nga ku si rrjedhojë janë paraqitur ankesa nga operatorët ekonomikë, kohëzgjatja e të cilave ka çuar autoritetin kontraktor në zhvillimin e 2 procedurave me negocim pa shpallje.

-Certifikatat e pranimit të mallrave janë hartuar në kundërshtim me Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, nënpikat 42, 43, 47 dhe 50.

-Mungon dokumentacioni mbi llogaritjen e fondit limit si dhe nuk ka asnjë urdhër nga titullari i AK, për përcaktimin e zyrtarëve që do të hartojnë përlllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”

-Hartimi i certifikatave të pranimit nga komisioni i marrjes në dorëzim është kryer në mënyrë të përciptë, pasi nuk janë detajuar të dhënat e verifikuara, për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues, sipas certifikatave, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, nënpikat 42, 43, 47 dhe 50, pasi në urdhrat e Titullarit si bazë ligjore për pranimin e mallrave nuk është vënë edhe udhëzimi i mësipërm, por vetëm ligji i prokurimit publik .

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria Përgjithshme e ALUIZNI-t si Autoritet Kontraktor të marrë masa:

-Njësia e Prokurimit, për të ardhmen, të marrë të gjitha masat, që kërkesat e veçanta për kualifikim të hartohen në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit, të përcaktohen kriteret kualifikimi të sakta dhe të kuptueshme, pa lënë shteg për interpretime. Kërkesat kualifikuese të veçanta, të hartuara e miratuara nga autoriteti kontraktor duhet të jenë të argumentuara dhe në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim arritjen e konkurrencës së nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

-Në procedurat “me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës” të dërgojë ftesa për negocim një numri të madh operatorësh ekonomik që operojnë në fushën për objektin e prokurimit, me qëllim arritjen e konkurrencës dhe kontratave me efektivitet të lartë.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Është konstatuar se janë lëshuar dy leje legalizimi në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale” i ndryshuar; neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” neni 28 “Dhënia e lejes së legalizimit”; neni 29 “Dokumentacioni për regjistrimin e objektit në ZRPP” (Ndryshuar me ligjin nr. 9895, datë 9.6.2008) (Ndryshuar me ligjin nr. 50/2014) si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me konkretisht:

-Subjekti vetëdeklarues ”G.....” është pajisur me Leje Legalizimi me nr. 70055369, datë 13.10.2016. Në arkivin e Drejtorisë Rajonale nuk ndodhet Leja e Legalizimit (Kopjo e dytë), por ndodhet vetëm **fotokopje**. Me shkresën nr. 066, datë 02.11.2016 Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: “Dërgim dokumentacioni për objektet e legalizuara” është dërguar në ZVRPP Tiranë Dosja: Godinë shërbimi (Qendra Tregtare T.....) 7 kat me 5 kate nën tokë si dhe me dokumentacionin shoqërues cituar në shkresë: Leje Legalizimi 1 Fletë; Gen Plani i objektit i hartuar si hartë treguese 1 fletë; Planimetri 12 fletë; Certifikatë Familjare 1 fletë; Kopje e vetëdeklarimit 1 fletë.

Dokumentacioni shoqërues cituar në shkresën e mësipërme si dhe Dosja e plotë e dokumentacionit nuk ndodhet në Arkivin e Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Rurale veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.1996 ”Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale” i ndryshuar si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat”.

-Subjekti vetëdeklarues ”D.M.Q” është pajisur me Leje Legalizimi (nuk disponohen të dhëna). Me shkresën nr. 067, datë 02.11.2016 Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: ”Dërgim dokumentacioni për objektet e legalizuara” (sipas librit të protokollit) është dërguar në ZVRPP Tiranë Leja e Legalizimit me dosjen e subjektit D.M.Q. Në momentin e auditimit në arkivin e Drejtorisë nuk ndodhet; Leja e Legalizimit (Kopjo e dytë) si dhe nuk ndodhet dokumentacioni shoqërues i dosjes. Me shkresën nr. 248, datë 13.02.2017. Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: ”Kërkesë për informacion” është dërguar në ZVRPP Tiranë kërkesa për informacion për regjistrimin e lejes së legalizimit në emër të D.M.Q. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.1996 ”Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale” i ndryshuar si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat”

Me shkresën nr. 1003, datë 19.04.2017 lënda ”Kthim i fletëve të leje të legalizimit” nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale, janë kthyer Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t flete e leje të legalizimit të firmosura nga Drejtori A.I dhe të vulosura por të pa plotësuar me nr. Serie 0138077 – 0138100, sipas fletë daljes me nr. 10, datë 17.02.2017.

### **10. 1. Rekomandimi:**

**a.** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t të marrë masa dhe të përgjithësojë rastin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH për legalizim të paligjshëm të kryer për objektin Qendër Tregtare T..., Tiranë nga subjekti G..... shpk dhe legalizimi i objektit që i përket shtetasit D.M.Q, për të parandaluar veprime të njëjta që janë në kundërshtim me ligjin.

b. Të merren masa dhe të kërkohet nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, për të evidentuar raste të kësaj natyre (pra përdorimi i Lejeve të Legalizimi në mënyrë të kundraligjshme), duke marrë masa që mos të krijohen raste të kësaj natyre.

### **Për Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rastë është shfaqur mangësi në dokumentacionin e përdorur për regjistrimin e pasurisë me leje legalizimi nr. 70055730 datë 01.11.2016, për pasurinë nr. 3/261, vol. 35, fq. 118, zk. 8210/Tiranë për D.M.Q sipas Certifikatës së pasurisë me nr. 1430343, lëshuar në datë 03.11.2016, regjistruar me Ref. 00011628, datë 03.11.2016 me sip. Ndërtimi 101.3 m<sup>2</sup> Nd pa marrëdhënie me truallin, pasi mungon formulari i pagesës së parcelës ndërtimore, ortofoto dixhitale, HTR e përditësuar në kundërshtim me VKM nr. 258, datë 04.05.2007 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, të legalizuara” pika 11.1 - Dorëzimi i dokumentacionit përkatës të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, në ZVRPP dhe Udhëzimin nr. 2532, datë 21.04.2009, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006; ”per legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” .

**1.1. Rekomandim:** Nga Regjistruesi i ZVRPP Tiranë, të merren masat për nxjerrjen e urdhrit të kufizimit në bazë të nenit 5.1, nenit 49.1 dhe nenit 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor mbi pasurinë nr. 3/261, vol. 35, fq. 118, ZK. 8210.

*Menjëherë*

### **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe në zbatim të “Ligjit të Prokurimit Publik” nr. 9643 datë 20.11.2006, **nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues)**, të merren masa dhe të nxirren aktet administrative përkatëse e ndjekjen në rrugë ligjore (*Padi Gjyqësore*), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në **3 raste me vlerë 556,216 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit “*Shërbimi i rojeve*” vitet 2016 dhe 2017 përllogaritja e fondit limit nga njësia e prokurimit është bërë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, neni 59, dhe ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 82 dhe 83 .

**1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë** të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 31.12.2015-11.05.2016 në vlerën **100,444 lekë** nga operatori ekonomik “S...” shpk., si përfitim i padrejtë.

**1.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 11.05.2016-07.04.2017 në vlerën **251,842 lekë** nga operatori ekonomik “T.....” shpk., si përfitim i padrejtë.

**1.3. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t Tiranë të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik për periudhën 07.04.2017–01.01.2018 në vlerën **203,931 lekë** nga operatori ekonomik “I.....” shpk., si përfitim i padrejtë.

*Deri në 30.11.2017*

## **C. MASA DISIPLINORE**

I. Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37,141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-T**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**, për këta punonjës:

**Masa “Vërejtje me shkrim” për 4 punonjës si më poshtë:**

**Znj.A.H**

**Znj.S.K**

**Z. K.Ç**

**Znj. L.K**

*me detyrë specialistë në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit, Për të metat e mangësi të konstatuara, pasi:*

- Në 3 raste në procedurat e prokurimit publik përlllogaritja e fondit limit nga njësia e prokurimit është bërë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu VII, neni 59, dhe ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i punës i republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, neni 82 dhe 83.

-Specifikimet teknike kanë mangësi në përcaktimin e tyre duke mos specifikuar saktë teknologjinë që duhet të përdorin punonjësit e shërbimit në subjekt.

II. Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37,141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr. 136/2015, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-T**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për punonjësin e cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” deri në “Largim nga Puna**, për:

**- E.Z me detyrë P/Sektori i Auditimit të brendshëm.**

*Për të metat e mangësi të konstatuara, pasi:*



Në hartimin e planeve vjetor të auditimit nuk janë parashikuar auditimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 (ndryshuar me ligjin nr. 10318 datë 16.09.2010) “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 7 “Objekti i auditimit të brendshëm” ku është përcaktuar: -iii) *dhënë rekomandime për përmirësimin e veprimtarive të njëjësive publike; c) raportimin dhe ndjekjen e veprimtarive pasuese për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të bëra;* neni 11 “Përgjegjësitë e drejtuesve të subjekteve publike për auditimin e brendshëm” ku përcaktohet: - a) *hartimin e planit të masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm apo drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm në subjektet e audituara, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar;* si dhe me Manualin e Auditimit miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010. pika 3.2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve” .

Në raportet e veprimtarisë nuk arsyetohet shkresërisht mos realizimi i planit të auditimit si dhe shmangiet nga ky plan veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 (ndryshuar me ligjin nr. 10318 datë 16.09.2010) neni 18 “Detyrat e njësisë së auditimit të brendshëm” pika 5.1. Ku përcaktohet: - *Angazhimet dhe objektin e auditimit, të kryer gjatë periudhës së raportuar, kohëzgjatjen e çdo auditimi dhe, nëse ka pasur shmangie nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse,* ligjin 114/2015 Neni 14 “Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm” ku përcaktohet: -*Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për: i)shmangiet nga plani, arsyet dhe argumentet përkatëse;* si dhe me Manualin e Auditimit pika 2.5 “Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetorë të auditimit të brendshëm”, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010. ku përcaktohet “*Çdo ndryshim i bërë planeve të auditimit duhet të aprovohet nga Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe gjithashtu duhet të bihet dakord me menaxhimin e organizatës. Të gjithë planet vjetorë dhe strategjike të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t’i dërgohen NjQH/AB së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra.*”

-Programet e auditimit jo në të gjitha rastet janë hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit, Manualit të auditimit dhe standardeve të auditimit të brendshëm. Në Programin Angazhim për Auditim nuk janë parashikuar kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet të mëparshëm, dhe nuk janë përcaktuar drejtimet e auditimit në kundërshtim me neni 8 “Standardet dhe metodologjia e auditimit të brendshëm” të Ligjit, Manualin e auditimit miratuar, me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016: piken 4.1.6 Hapi 5: “*Përgatitja e programit të angazhimit të auditimit për të testuar nëse kontrollet e parashikuara veprojnë në mënyre efektive*” Standardi 2240 - *Programi i punës së angazhimit dhe formatin “standart 8”* , me Pika 4.1.13.1 “*Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit*” Standardi 2500 – “*Monitorimi i zbatimit rekomandimeve. Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit.*”

**Për 10 punonjës aktual, nuk propozojmë masë, pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit, nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore, si më poshtë:**

D.V, G.M, V.D, K.SH, B.GJ, R.H, J.V, T.K, A.T dhe SH.M,

## **D. KALLËZIM PENAL:**

Bazuar në nenin 281, të ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika “gj” e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe VKM nr. 438, datë 28.06.2006 ”Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar me VKM nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje", *sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik rast pas rasti* nga ana e Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit, në kuptim të referencave të Kodit Penal **për 2 punonjës**, si më poshtë:

**1. Z. A.I, me detyrë ish-Drejtor i ALUIZNI-t Tirana Rurale.**

**2. Z. O.S, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Tirana Rurale**

*Për shkeljet:*

Janë lëshuar dy leje legalizimi në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale” i ndryshuar; neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit” (*Ndryshuar me ligjin nr. 9786, datë 19.7.2007*) (*Ndryshuar me ligjin nr. 9895, datë 9.6.2008*) (*Shtuar shkronja “f ” me ligjin nr. 10 169, datë 22.10.2009*) (*Ndryshuar me ligjin nr. 50/2014*) (*Ndryshuar shkronja d me ligjin nr. 62/2015*); neni 28 “Dhënia e lejes së legalizimit”; neni 29 “Dokumentacioni për regjistrimin e objektit në ZRPP” (*Ndryshuar me ligjin nr. 9895, datë 9.6.2008*) (*Ndryshuar me ligjin nr. 50/2014*) si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat” me konkretisht:

-Subjekti vetëdeklarues ”G.....” është pajisur me Leje Legalizimi me nr. 70055369, datë 13.10.2016. Në arkivin e Drejtorisë Rajonale nuk ndodhet Leja e Legalizimit (Kopjo e dytë), por ndodhet vetëm Fotokopje. Me shkresën nr. 066, datë 02.11.2016 Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: “Dërgim dokumentacioni për objektet e legalizuara” është dërguar në ZVRPP Tiranë Dosja: Godinë shërbimi 7 kat me 5 kate nën tokë si dhe me dokumentacionin shoqërues cituar në shkresë: Leje Legalizimi 1 Fletë; Gen Plani i objektit i hartuar si hartë treguese 1 fletë; Planimetri 12 fletë; Certifikatë Familjare 1 fletë; Kopje e vetëdeklarimit 1 fletë.

Dokumentacioni shoqërues cituar në shkresën e mësipërme si dhe Dosja e plotë e dokumentacionit nuk ndodhet në Arkivin e Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana Rurale veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.1996 ”Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale” i ndryshuar si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 “Për arkivat”.

-Subjekti vetëdeklarues ”D.M.Q” është pajisur me Leje Legalizimi (nuk disponohen të dhëna). Me shkresën nr. 067, datë 02.11.2016 Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: ”Dërgim dokumentacioni për objektet e legalizuara” (sipas librit të protokollit) është dërguar në ZVRPP Tiranë Leja e Legalizimit me dosjen e subjektit D.M.Q. Në

momentin e auditimit në arkivin e Drejtorisë nuk ndodhet; Leja e Legalizimit (Kopjo e dytë) si dhe nuk ndodhet dokumentacioni shoqërues i dosjes. Me shkresën nr. 248, datë 13.02.2017 Nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale Lënda: "Kërkesë për informacion" është dërguar në ZVRPP Tiranë kërkesa për informacion për regjistrimin e lejes së legalizimit në emër të D.M.Q. Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.1996 "Për legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave/Ndërtimeve Informale" i ndryshuar si dhe me aktet nënligjore dalë në zbatim, si dhe ligjin nr. 9154, date 06.11.2003 "Për arkivat"

Me shkresën nr. 1003, datë 19.04.2017 lënda "Kthim i fletëve të leje të legalizimit" nga Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana Rurale, janë kthyer Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t flete e leje të legalizimit të firmosura nga Drejtori A.I dhe të vulosura por të pa plotësuar me nr. Serie 0138077 – 0138100, sipas fletë daljes me nr. 10, datë 17.02.2017.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**